

**GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË****KA NR. 185/2010****P Nr. 200/10**

7 shkurt 2011

Gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës, Gianfranco Gallo, gjyqtar i EULEX-it, pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i caktuar për këtë rast, në pajtim me letrën për caktimin e gjyqtarit, data, 04 janar 2011, në çështjen penale kundër të pandehurve:

Sllavisha Petkoviç, Branisllav Grbiç, Nemanja Vujoviç, Muhamet Sadiku, Ruzhdi Prebreza, Ismet Hasani, Fidan Sadiku, Rifat Sadiku, Shemsi Haliti, Gani Zeneli dhe Driton Hamiti, me të dhëna personale sikurse në procesverbalin e seancës për konfirmimin të Aktakuzës, të datës 18 janar 2011.

Të akuzuar për veprat penale sikurse më poshtë, në pajtim me Aktakuzën e ngritur më 06 gusht 2010, nga Prokurorja e PSRK-së, Maria Bamieh:

**Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës**, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 340, paragrafët 1 dhe 3, të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), në lidhje me nenin 23, të KPK-së (kundër, Sllavisha Petkoviçit, Branisllav Grbiçit, Nemanja Vujoviçit, Muhamet Sadikut, Ruzhdi Prebrezës, Ismet Hasanit, Fidan Sadikut, Rifat Sadikut, Shemsi Halitit, Gani Zenelit dhe Driton Hamitit);

**Shpërdorimi**, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 257, paragrafët 1 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), në lidhje me nenin 23, të KPK-së (kundër, Sllavisha Petkoviçit, Branisllav Grbiçit, Nemanja Vujoviçit, Muhamet Sadikut, Ruzhdi Prebrezës, Ismet Hasanit, Fidan Sadikut, Rifat Sadikut, Shemsi Halitit, Gani Zenelit dhe Driton Hamitit);

**Mashtrimi në detyrë**, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 341, paragrafët 1 dhe 3, të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), në lidhje me nenin 23, të KPK-së, (kundër, Sllavisha Petkoviçit, Branisllav Grbiçit, Nemanja Vujoviçit, Muhamet Sadikut, Ruzhdi Prebrezës, Ismet Hasanit, Fidan Sadikut, Rifat Sadikut, Shemsi Halitit, Gani Zenelit dhe Driton Hamitit);

**Marrja e ryshfetit**, në pajtim me nenin 343, paragrafin 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), (kundër, Nemanja Vujoviçit);

**Dhënia e ryshfetit**, në pajtim me nenin 344, paragrafi 1, i Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), (kundër, Ruzhdi Prebrezës);

**Falsifikimi i dokumenteve zyrtare**, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 348, paragrafi 2, të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), në lidhje me nenin 23, të KPK-së, (kundër, Nemanja Vujoviçit, Muhamet Sadikut, Ruzhdi Prebrezës, Ismet Hasanit, Fidan Sadikut, Rifat Sadikut, Shemsi Halitit, Gani Zenelit dhe Driton Hamitit);

**Falsifikim i dokumenteve**, në bashkëveprim, në pajtim me nenin 332, paragrafi 3, i Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), në lidhje me nenin 23, të KPK-së, (kundër, Nemanja Vujoviçit, Muhamet Sadikut, Ruzhdi Prebrezës, Ismet Hasanit, Fidan Sadikut, Rifat Sadikut, Shemsi Halitit, Gani Zenelit dhe Driton Hamitit);

pas mbajtjes së seancave për konfirmimin e Aktakuzës, në pajtim me nenin 314, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), më 15 dhjetor 2010, më 18 janar 2011 dhe përfundoi më 25 janar 2011, në praninë e të akuzuarve të lartpërmendur dhe të avokatëve të tyre mbrojtës, me praninë e Prokurores së PSRK-së dhe përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar, nga Ministria e Drejtësisë;

duke vendosur mbi konfirmimin apo hedhjen poshtë të Aktakuzës, sikurse është ngritur nga PSRK-ja, më 06 gusht 2010, sikurse është lexuar më herët para palëve gjatë seancave për konfirmimin Aktakuzës;

në pajtim me nenin 316 (4), të KPPK-së, me anën e kësaj nxjerr sikurse më poshtë:

## **AKTVENDIM**

Aktakuza PP No. 58/2010, e ngritur nga Prokurorja i PSRK-së, në këtë Gjykatë, më 06 gusht 2010, **konfirmohet**.

Aktakuza, së bashku me regjistrimet e dosjes së lëndës, do të dërgohen tek Kryetari i Trupit gjykues, i shqyrtimit kryesor, menjëherë pasi që ky Aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

### **Arsyetim**

Më 06 gusht 2010, Prokurorja e PSRK-së, ngriti Aktakuzën kundër të pandehurve të lartpërmendur dhe i paraqiti akuzat sikurse të përshkruara më lart.

Nënkryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it me anën e letrës për caktimin e gjyqtarëve caktoi gjyqtarin e poshtëshënuar, më 04 janar 2011, duke e zëvendësuar gjyqtarin e kaluar për konfirmimin e Aktakuzës, të caktuar më 25 gusht 2010.

Seancat publike për konfirmimin e Aktakuzës ishin mbajtur më 15 dhjetor 2010, 18 janar 2011 dhe 25 janar 2011.

Prokurori e ka lexuar Aktakuzën në pajtim me nenin 314 (3), të KPPK-së.

Pas pyetjes së të pandehurve nëse e kanë kuptuar Aktakuzën, gjyqtari u dha atyre rastin që të deklarohen fajtor apo jo fajtor, sikurse të paraqitura në nenin 314 (4), të KPPK-së. Të gjithë të pandehurit e bënë me dije se e kishin kuptuar Aktakuzën dhe u deklaruan jo fajtor. Gjyqtari pastaj ia dha fjalën avokatëve mbrojtës për komente të mëtejme, sikurse në pajtim me nenin 314 (5), të KPPK-së, dhe pastaj të pandehurve për komentet e tyre përfundimtare.

### **Gjetjet e Gjykatës:**

Duke u mbështetur në dëshmitë të përfshira në dosje, ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme që e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat ata janë akuzuar. Hetimet kanë përfshirë intervistat me një numër dëshmitarësh, zyrtarë dhe të punësuar në MKK, vlerësime të kontratave për punë ndërtimore të bëra në të mirë të MKK-së, të dhëna financiare të të pandehurve dhe dëshmi të tjera që lejojnë të përfundohet se ekziston dyshimi i bazuar mirë për elementet e akuzave të përfshira në Aktakuzë, që do të thotë, se të pandehurit kanë keqpërdorur fondet e MKK-së dhe duke vepruar kështu, kanë kryer vepra penale, sikurse janë akuzuar në Aktakuzë.

Historiku faktik i krimeve është se ky rast u ngrit pas raportit të auditorit, për vitin 2005, duke treguar humbjen e 1.1 milionë eurove nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK-së).

Pas shpalljes në raportin e Auditorit gjeneral, në vitin 2005, një hetim kishte filluar dhe kishte zbuluar se shumë kontrata ishin hartuar brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore (nga 01 korriku , deri më 13 shtator 2006) pasi që punët e supozuara duhej të ishin ndërmarr. Disa nga projektet që të rindërtohen shtëpitë e të kthyerve në emër të MKK-së, nuk ishin ekzekutuar kurrë. Gjatë inspektimeve në lokacione të ndryshme ka rezultuar se kontratat në tërësi ishin fiktive.

Sido që të jetë, ku kontraktuesit, d.m.th-në, nënshkruesit e kontratës, ishin marr në pyetje, ata të gjithë individualisht dhe kolektivisht deklaruan të njëjtën gjë se ata kanë bërë punë të tjera për të cilat nuk kishin kontrata dhe me qëllim që të paguhen ata është dashur që të nënshkruajnë kontrata dhe fatura false.

Gjithashtu ka ndodhur që një pjesë e punëve që ishte bërë nga këta kontraktues kanë përfshirë renovime të gjëra të shtëpisë së Ministrit Petkoviç, të shtëpisë së zyrtarit të prokurimit, Z. Nemanja Vujoviç, të shtëpisë së shoqes së Ministrit, Marina Dimitrioviç, të shtëpisë së Anisa Rexhepit, sekretares së Ministrit Petroviç, dhe gjithashtu renovime ishin bërë në restorantin e quajtur "Tropicana". Të gjitha këto punë nuk shihet se kishte ndonjë arsye të lidhen në fushën e aktiviteteve të MKK-së.

Humbjen e përgjithshme që Aktakuza ishte në gjendje të e dëshmoj në bazë të kontratave, është rreth 600,000 euro. Entiteti i cili humbi të holla nga kjo sjellje mashtruese ishte Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, e cila ka paguar për këto kontrata false.

Avokatët mbrojtës kanë ngritur një numër çështjesh dhe të gjitha i ka kundërshtuar në Aktakuzë, dhe kanë kërkuar që Gjykata të hedh poshtë Aktakuzën dhe të ndërpres procedurat kundër klientëve të tyre.

Çështjet e ngritura janë sikurse më poshtë:

1. Veprat penale për të cilat të pandehurit janë akuzuar nuk janë në pajtim me nenin 305, paragrafin 1, pikat 3, 4 dhe 5, të KPPK-së; që do të thotë se veprat penale të përshkruara në Aktakuzë nuk janë të sakta, u mungon përcaktimi i kohës dhe i vendit, shuma e saktë e të hollave dhe rolet e secilit të pandehur.
2. Veprat penale të kryera nga personat zyrtar nuk janë të zbatueshme për të pandehurit të cilët nuk ishin të punësuar në MKK.

3. Dëshmia sa i përket udhëheqjes së bashkëveprimit në mes të personave zyrtar dhe të pandehurve të tjerë (pronarët e kompanive të ndërtimit), mungonin apo ishin të pamjaftueshme.
4. Disa nga të pandehurit (pronarët e kompanive ndërtimore), nuk kanë marr ndonjë fitim të paligjshëm, por thjesht janë paguar për punën të cilën e kanë bërë.
5. Kontratat ishin hartuar nga personi zyrtar i MKK-së, ndërsa, pronarët e kompanive ndërtimore nuk kanë bërë dokumentet apo të i falsifikojnë ato, prandaj, ata nuk janë përgjegjës për veprat penale, në pikat 6 dhe 7.
6. Hetimet ishin vazhduar deri më 31 dhjetor 2007, deri sa Aktakuza ishte ngritur më 06 gusht 2010.
7. Vonesa në pranimin e deklaratave të Sllavisha Petkoviçit dhe Branisllav Grbiçit dhe intervistimi i tyre pas ngritjes së Aktakuzës është në kundërshtim me ligjin, e shoqëruar me pranimin e vonshëm të dëshmive, pasi që Aktakuza ishte ngritur.

Gjykata vjen ne përfundim se çështjet e ngritura në pikat e lartpërmendura , 1 dhe 2, nuk janë plotësisht të pa justifikuar; sido që të jetë, Aktakuza në tërësinë e saj, duke e marr nën konsiderim jo vetëm pikat, por edhe arsyetimin dhe shpjegimin faktit, është e mjaftueshme që të lejon të pandehurit që të kuptojnë akuzat kundër tyre dhe të ua mundësoj atyre dhe avokatëve të tyre mbrojtës që të përgatisin mbrojtjen e tyre për shqyrtimin kryesor.

Në fakt, një specifikim më i saktë i akuzave dhe i rolit të secilit të pandehur, do të ishte më i përshtatshëm, por sido që të jetë, ajo nuk mund të konfirmohet se Aktakuza nuk i plotëson kërkesat e nenit 305, paragrafit 1, pikave 3, 4 dhe 5, të KPPK-së. Më konkretisht, sa i përket vendit dhe kohës të kryerjes së krimeve, që të dyja ato janë qartë të treguara në akuzat dhe prandaj i jep mbrojtjes mundësi që të ketë renditje në kohë dhe hapësirë të zhvillimeve.

Për më shumë, në pikën e lartpërmendur 3, është e qartë nga leximi i tërësishtëm i Aktakuzës se ishte një marrëveshje në mes të personave privat dhe zyrtarë lidhur me faturat false dhe lidhur me punët të cilat kurrë nuk ishin kryer apo të kryera ilegalisht.

Gjykata vjen në përfundim se çështjet e ngritura në pikën e lartpërmendur 2, janë krejtësisht të pabaza.

Në fakt, është e padiskutueshme se veprat penale të Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, mashtrimit në detyrë dhe falsifikimi i dokumenteve zyrtare duhet që të kryhen nga personat zyrtarë, por në

anën tjetër, pasi që krimet e lartpërmendura ishin kryer në bashkëveprim nga personat zyrtarë, Petkoviç, Grbiç dhe Vujoviç, me pronarët e kompanive ndërtimore, gjithashtu edhe personat privat duhet që të konsiderohen përgjegjës për krimet e lartpërmendura.

Me fjalë të tjera, në rast se kualifikimi legal i krimit ndryshon, për shkak të cilësisë së një (apo më shumë) fajtorëve (për shembull, përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës për arsye se një person zyrtar është i përfshirë) të gjithë njerëzit të cilët kanë bashkëpunuar me person zyrtar, edhe nëse nuk e kanë pozitën zyrtare, do të kryejnë krim të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës, dhe jo thjesht të keqpërdorimit.

Gjykata vjen në përfundim se çështjet e ngritura në pikat e lartpërmendura 4 dhe 5, nuk janë të bazuara pasi që të pandehurit të vetëdijshëm kanë bërë fatura dhe kanë nënshkruar kontrata për punët të cilat kurrë nuk janë bërë apo i kanë bërë për të mirën personelit të MKK-së dhe jashtë fushës së aktiviteteve të MKK-së. Prokurori në këtë pikë ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme që të mbështet dyshimin bazuar mirë kundër të pandehurve.

Gjykata vjen në përfundim se çështjet e ngritura në pikën 6, janë të pabazuara. Neni 304, paragrafi 1, i KPPK-së nuk jep një afat kohor për Prokurorinë që të ngrit Aktakuzën, por thjesht cek se pasi që hetimi të jetë përfunduar, Aktakuza mund të ngritet nëse ka arsye të mjaftueshme për ngritjen e Aktakuzës.

Gjykata vjen në përfundim se çështjet e ngritura në pikën 7, sikurse më lart, nuk janë në tërësi pa arsye.

Në fakt, neni 229, i KPPK-së nuk cek se të pandehurit do të ekzaminohen në fund para përfundimit të hetimeve. I pandehuri, Sllavisha Petkoviç ishte marr në pyetje gjatë hetimeve nga hetuesit e CIVPOL, të UNMIK-ut, më 21 prill 2008, në praninë e avokatit të tij mbrojtës Zef Prenaj. Kjo është e mjaftueshme (neni 229 nuk përcakton që ekzaminimi të udhëhiqet nga Prokurori), të përmbush dispozitën e nenit 229, të KPPK-së.

Përkundrazi, i pandehuri Branislav Grbiç, ishte intervistuar si dëshmitar nga CIVPOL, i UNMIK-UT, më 21 mars 2008, dhe ka dhënë deklaratën si dëshmitar, më 15 janar 2007. Ai ishte intervistuar si i dyshuar nga Prokurori i PSRK-së, më 23 dhjetor 2010, në praninë e avokatit të tij, Zhivojin Jakanoviç.

Është e padiskutueshme, se dispozita e nenit 229, e KPPK-së ishte zbatuar gabimisht lidhur me të pandehurin Grbiç, por, sido që të jetë,

Gjykata vije në përfundim që pasi që seanca për konfirmimin e Aktakuzës në të vërtetë ishte mbajtur pasi që Prokurori kishte intervistuar të pandehurin si të dyshuar, shkelja e lartpërmendur nuk mund të konsiderohet si substanciale.

Në fakt, lëshimi i bwr i lartpërmendur nuk do të ndikoj në bërjen Aktgjykimit të duhur (neni 403, paragrafi 2, i KPPK-së), pasi që gjyqtarit për konfirmimin e Aktakuzës dhe palëve u janë dhënë deklaratat para seancës për konfirmimin e Aktakuzës dhe prandaj, mbrojtja do të mund të gjente argumentet e saja gjithashtu në bazat e deklaratave të lartpërmendura.

Gjykata e di për dispozitat e nenit 317 (1), të KPPK-së, që Aktvendimi i konfirmimit dhe arsyetimi i tij do të hartohet në atë mënyrë që nuk do të paragjykoj gjykimin e çështjeve e cila do të konsiderohet në shqyrtimin kryesor. Si të tilla çështjet e ngritura mund të vlerësohen nga Trupi gjykues gjithashtu dhe prandaj të drejtat e mbrojtjes nuk janë shkelur në këtë fazë.

#### **Pranueshmëria e dëshmimeve:**

Në këtë fazë Gjykata nuk ka deklaruar asnjë nga dëshmitë e propozuara, si dëshmi të papranueshme.

Avokati mbrojtës i Ruzhdi Prebrezës, ngriti pyetjen e papranueshmërisë së deklaratës së dhënë nga klienti i tij gjatë intervistës në polici, më 29 tetor 2006. Nga dosja e lëndës del se i pandehuri, Prebreza ishte marr në pyetje pa praninë e avokatit të tij mbrojtës.

Në anën tjetër, rezulton nga deklarata e lartpërmendur se ai ishte informuar lidhur me të drejtat e tij dhe në mesin e të tjerave për të drejtat e asistimit të menjëhershëm të avokatit mbrojtës.

Të kuptuarit e dispozitave të neneve 231 dhe 213, të KPPK-së (Prebreza ishte intervistuar deri sa ishte arrestuar) e bënë të qartë se i pandehuri ka më të vërtetë të drejtë që të ketë asistencën e avokatit mbrojtës, por prania e avokatit gjatë ekzaminimit nuk është e detyrueshme.

Pasi që Z. Prebreza nuk ka ushtruar të drejtën e tij që të merret në pyetje në praninë e avokatit mbrojtës, ekzaminimi ka qenë krejtësisht legjitim.

Për më shumë, neni 235,i KPPK-së ka në të shkeljet që e bën deklaratën e dhënë nga i pandehuri të papranueshme dhe rrethana që

ekzaminimi nuk u bë në praninë e avokatit nuk është treguar në mesin e shkeljeve të lartpërmendura.

Avokati, Ramë Gashi, ngriti çështjen se ekziston dëshmia e papranueshme, në pajtim me nenin 156 (1) dhe (2), i KPPK-së, lidhur me klientin e tij, të pandehurin, Nemanja Vujoviç. Sido që të jetë, përveç kësaj kërkesë të paqartë dhe të përgjithshme, Gjykata nuk ka marr detaje se mbi cilën dëshmi do të deklaroj si të papranueshme dhe arsyet për të. Përfundimi është qartë, shumë i paqartë për të u vlerësuar. Në asnjë mënyrë, Gjykata nuk ka gjetur se ndonjë pjesë e dëshmive kundër të pandehurit Vujoviç ishin të papranueshme.

Dëshmitë e reja të dorëzuara në Gjykatë, nga avokati, Ramë Gashi (kontrata për punësim për Nemanja Vujoviç), dhe avokati, Ahmet Ahmeti (për Fidan Sadikun) nuk janë të pranueshme në pajtim me nenin 314 (6), të KPPK-së, sikurse drejtë është vërejtur nga Prokurori dhe prandaj do të kthehet prapa tek avokatët me qëllim të parashtrihen gjatë shqyrtimit kryesor.

Asnjë dëshmi tjetër tani nuk është gjetur të jetë e papranueshme.

#### **Dëshmitarë të tjerë që të ftohen për shqyrtimin kryesor:**

Milloran Smiliç ishte propozuar si dëshmitar nga mbrojtja.

PSRK-ja, i ka dorëzuar Gjykatës në dorëshkrim listën e emrave të dëshmitarëve që të ftohen për shqyrtimin kryesor, e bashkëngjitur në procesverbalin e seancës së konfirmimit të Aktakuzës, të datës 18 janar 2011.

Kështu, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Aktvendimi.

Data, 07 shkurt 2011.

#### **Gjyqtari për Konfirmimin e Aktakuzës**

Gianfranco Gallo

Gjyqtar Penal i EULEX-it, Niveli i Gjykatës së Qarkut

**KËSHILLA LIGJORE:** Aktvendimi me anën e së cilës konfirmohet Aktakuza është **e formës së prerë.**